**KORRIGJIM GABIMI MATERIAL**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 29.12.2021, "Për miratimin e planit analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 2/2022, **shtohet tabela e Ministrisë së Mbrojtjes.**

**Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve, për vitin 2022**

**Ministria e Mbrojtjes**

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE?<br><br>Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021–2025<br><br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br><br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br><br>Përgjigjuni me po/jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese". | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Synon të përafrojë pjesërisht rregulloren e BE-së, CELEX 02005R1236, të 27 qershorit 2005, "Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese", ndryshuar me rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (EU) 2016/2134, datë 23 nëntor 2016. | Përcaktimi i kritereve për import-eksportin e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese. | Po, kapitulli 30 | Shtylla; Shqipëria e fortë,<br>fusha: Integrimi evropian | N/A | Po |
| 2 | "Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen si pasojë e një fatkeqësie". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Neni 41, pika 6, e ligjit nr. 45/2019, ka përcaktuar se masa e kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. | Përcaktimi i masës së kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 3 | "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjen civile". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Neni 23, pika 6, germa "d", e ligjit nr. 45/2019, ka përcaktuar se AKMC-ja planifikon fonde për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive,<br>në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, kriteret dhe procedurat e akordimit të të cilave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. | Përcaktimi i kritereve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 4 | "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Pika 2 e nenit 48 përcakton se baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë krijohet dhe funksionon pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas përcaktimit për mënyrën e mbledhjes dhe administrimit të dhënave të humbjes nga fatkeqësitë, të bërë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. | Përcaktimin i mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të Bazës së të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 5 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 156, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e statusit të veçantë AFA, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizmin dhe funksionimin e saj". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Në vijim të procesit të transformimit të strukturës me qëllim përshtatjen me modelin e akademisë ushtarake amerikane "*West Point*". | Ndryshim të njësive kryesore të Akademisë së Forcave të Armatosura. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 6 | "Për trajtimin dhe mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë kohës që emërohen me detyrë jashtë vendit, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Nëpërmjet projektvendimit synohet të përmirësohen aspektet e trajtimit financiar dhe përballimit të shpenzimeve të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të emëruar jashtë vendit, si dhe të familjarëve që e shoqërojnë këtë | Përmirësimi i trajtimit financiar dhe përballimit të shpenzimeve të personelit ushtarak dhe civil të MM/FA, të emëruar jashtë vendit, si dhe të familjarëve që shoqërojnë këtë personel. | Jo | Jo | N/A | Jo |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | huaja, të atasheve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës SECI, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe të punonjësve të sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural për kohën që shërbejnë si përfaqësues të kësaj ministrie pranë misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel dhe prokurori i sistemit të prokurorisë për kohën që shërben si prokuror ndërlidhës pranë EUROJUST, në Hagë, Holandë', i ndryshuar". | | | | personel. | | | | | |
| 7 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 694, datë 21.11.2018, "Për miratimin e modelit të uniformës, gradave dhe shenjave që mbahen në uniformë, si dhe stemave". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Rishikimi i modelit të uniformës, gradave dhe shenjave që mbahen në uniformë. | Përfshirja e albumit të modelit të stemave të strukturave dhe flamujve dekorativë që mbajnë FARSH, rregullime dhe ndryshime në të gjitha albumet ekzistuese. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 8 | "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për trafikun detar". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Nëpërmjet projektvendimit synohet deburokratizimi i procedurave të administrimit të të dhënave dhe formularëve për hyrjen dhe daljen e mjeteve lundruese nga portet tona, duke mundësuar pasqyrimin e tyre në kohë reale. | Përcaktimi i mënyrës së ruajtjes dhe administrimit të të dhënave të tjera shtetërore, në serverët e AKSHI-t, të cilat mund të përdoren nga secili përdorues sipas nivelit të aksesit. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 9 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, 'Për statusin e ushtarakut të FA-së'". | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Rishikim i pjesshëm i ligjit. | Të njihet si vjetërsi në punë e ushtarakut të Forcave të Armatosura, për efekt pensioni, periudha nga data e hyrjes në shërbim të Forcave të Armatosura, si ushtar me pagesë/profesionist, kursant (nënoficer), student në shkollat e larta ushtarake dhe student të diplomuar në shkollat civile të dërguara si kontingjent në interes të Ministrisë së Mbrojtjes. | Jo | Jo | N/A | Po |
| 10 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2015, 'Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH'". | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Rishikim i pjesshëm i ligjit. | Mirëpërcaktimi i kompetencave dhe ndarjes së detyrave. | Jo | Jo | N/A | Po |
| 11 | "Për një ndryshim në ligjin nr. 173/2014, 'Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar". | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Përshtatja me Kodin e Procedurave Administrative. | Mungesa e të drejtës për të pasur ndihmës në proces. | Jo | Jo | N/A | Po |
| 12 | "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Polonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes". | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Projektakti është propozuar për të përcaktuar kornizat ligjore dhe dispozitat e përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet palëve për çështjet e mbrojtjes. | Projektakti parashikon në vija të përgjithshme bashkëpunimin në fushat e operacioneve të kërkim-shpëtimit, stërvitjet e përbashkëta ushtarake, trajnimin dhe edukimin e personelit civil dhe ushtarak, industrinë e mbrojtjes, shkencën dhe teknologjinë, etj. | Jo | Jo | N/A | n/a |
| 13 | "Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për blerjet në një vend të tretë, duke përfshirë edhe blerjet e kryera, kur Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë dislokuar jashtë territorit të vendit". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Shkronja "ç", e pikës 1 dhe pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", përcakton se procedurat e prokurimeve të bëra në një vend të tretë, duke përfshirë prokurimet civile, të kryera kur FARSH janë dislokuar jashtë territorit të vendit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. | Përcaktimi i mënyrës dhe procedurave të përdorimit të fondeve, për kryerjen e blerjeve të mallrave/shërbimeve apo pajisjeve për FARSH, kur janë të dislokuar jashtë territorit të vendit, si dhe do të kontribuohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e gatishmërisë së FARSH-it në këto misione/stërvitje, duke iu përgjigjur kështu nevojave të vendeve aleate. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 14 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 614, datë 7.9.2011, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e kritereve dhe | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Ndryshimi i normave të trajtimit me uniformë. | Ndryshimi i normave të trajtimit me uniformë dhe përfshirja në | Jo | Jo | N/A | Jo |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | normat e trajtimit me uniformë të ushtarakëve të FARSH', i ndryshuar" | | | | | listë e studentëve. | | | | |
| 15 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 275, datë 13.4.2016, të Këshillit të Ministrave, 'Për modelin, përshkrimin, rregullat, procedurat dhe dhënien e medaljeve dhe certifikatave në FARSH'". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Thjeshtimi i procedurës së dhënies së medaljeve për ushtarakët e FARSH. | Rishikimi i listës së dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti të cilit i jepet medalja. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 16 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 121/2015, "Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit (PAZH) të FA 2016–2025". | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Rishikimi i PAZH duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit në FARSH. | Përditësimi i PAZH me ndryshimet e viteve të fundit. | Jo | Jo | N/A | Po |
| 17 | "Për miratimin e listës së mallrave të cilët mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Anekset II–III–IV, e rregullores (BE) 2019/125, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 16 janarit 2019, në lidhje me tregtinë e mallrave të caktuara që mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues. | Përcaktimi i listës së mallrave të cilët mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese | Po, kapitulli 30 | Shtylla: Shqipëria e fortë, fusha: Integrimi evropian | N/A | Jo |
| 18 | "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Pika 1, e nenit 10, të ligjit 45/2019, "Për mbrojtjen civile" përcakton se Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit. | Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 19 | "Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Pika 4, e nenit 14, të ligjit 45/2019, "Për mbrojtjen civile" përcakton se Plani Kombëtar për Emergjencat Civile miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. | Miratimi i Planit Kombëtar për Emergjencat Civile. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 20 | "Për vlerësimin e riskut në nivel qendror". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Pika 3, e nenit 9, të ligjit 45/2019, "Për mbrojtjen civile" përcakton se vlerësimi i riskut në nivel qendror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. | Realizimi i vlerësimit të riskut në nivel qendror. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 21 | "Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Pika 3, e nenit 47, të ligjit 45/2019, "Për mbrojtjen civile" përcakton se ngritja dhe funksionimi i sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112 miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit përgjegjës për emergjencat civile dhe të ministrit përgjegjës për punët e brendshme. | Ngritja dhe funksionimin i sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 22 | "Për përcaktimin e procedurave, kushteve, kritereve, afateve, vlefshmërisë dhe formateve për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, tranzitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Pika 1, e nenit 22, të ligjit nr. 74/2021, përcakton se procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, tranzitimin, përdorimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse miratohen me propozimin e ministrisë përgjegjëse. | Përcaktimi i procedurave, kushteve, kritereve, afateve, vlefshmërisë dhe formateve për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, tranzitimin, përdorimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 23 | "Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe të identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Pika 6, e nenit 14, të ligjit nr. 74/2021, përcakton se rregullat dhe procedurat e krijimit të sistemit të gjurmimit dhe identifikimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit të Mbrojtjes. | Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të krijimit të sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil. | Po, kapitulli 1 | Shtylla; Shqipëria e fortë, fusha: Integrimi evropian | N/A | Jo |
| 24 | "Për përcaktimin e procedurave, kushteve, kritereve, afateve, vlefshmërisë dhe formateve për dhënien, shfuqizimin dhe | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Pika 1, e nenit 25, të ligjit nr. 72/2021 përcakton se kushtet e posaçme të | Përcaktimi i kushteve të posaçme të licencimit dhe autorizimit, | Jo | Jo | N/A | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, tranzitimin e artikujve piroteknike për përdorim civil". | | | | licencimit dhe autorizimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë apo autorizim, afati i vlefshmërisë së licencës dhe autorizimit, procedurat e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e shfuqizimit/pezullimit të licencave e autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, tranzitimin dhe asgjësimin e artikujve piroteknikë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrive dhe strukturave përgjegjëse. | dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë apo autorizim, afati i vlefshmërisë së licencës dhe autorizimit, procedurat e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e shfuqizimit/pezullimit të licencave e autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, tranzitimin dhe asgjësimin e artikujve piroteknikë. | | | | |
| 25 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1085, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Përcaktimin e rregullave të prokurimit për kontratat për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave'". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Përcaktimi i qartë i kompetencave të Komisionit të veçantë të klasifikimit. | Mirëpërcaktimi i kompetencave dhe përgjegjësive të secilit anëtar dhe strukturave të tjera brenda FARSH në raport me veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Komisionit të veçantë të klasifikimit. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 26 | "Për miratimin e 'Notës së Aderimit/Deklarimit të Synimit, për t'u bërë pjesë në Memorandumin e Mirëkuptimit (MoU) ndërmjet qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve/aktiviteteve të ngjashme ushtarake të NATO-s'". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Ky memorandum lidhet për mbështetjen dhe ekzekutimin e operacioneve dhe stërvitjeve të përbashkëta me NATO-n. | Memorandumi rregullon veprimtarinë e angazhimit të forcave të NATO-s, gjatë operacioneve dhe stërvitjeve të përbashkëta që mund të zhvillohen në Luksemburg ose gjatë kalimit transit në këtë vend. Vendi ynë bëhet pjesë nëpërmjet Notës së Aderimit/Deklarimit të Synimit. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 27 | "Për miratimin e 'Notës së Aderimit/Deklarimit të Synimit, për t'u bërë pjesë në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior'". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Memorandumi lidhet për mbështetjen dhe ekzekutimin e operacioneve dhe stërvitjeve të përbashkëta me NATO-n. | Memorandumi rregullon veprimtarinë e angazhimit të forcave të NATO-s, gjatë operacioneve dhe stërvitjeve të përbashkëta që mund të zhvillohen në Malin e Zi, ose gjatë kalimit transit në këtë vend. Vendi ynë bëhet pjesë nëpërmjet Notës së Aderimit/Deklarimit të Synimit. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 28 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 9, datë 11.1.2016, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e kritereve të përfitimit të veshmbathjeve civile për punonjësit e policisë ushtarake në FARSH'". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Ndryshimi i rrethit të subjekteve përfitues. | Trajtimi me veshmbathje i personelit të Policisë Ushtarake. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 29 | Për miratimin nga Këshilli i Ministrave të "Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe shtetit të Izraelit". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Përforcimi i marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes dhe krijimi i një kuadri ligjor të plotë për bashkëpunim në të ardhmen. | Rregullime në aspektin ligjor dhe financiar të aktiviteteve dhe veprimtarisë së përbashkët ndërmjet dy vendeve. | Jo | Jo | N/A | Jo |
| 30 | Për organizimin dhe funksionimin e IGJIU-së. | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Me qëllim rregullimin e veprimtarisë së IGJIU-së pas miratimit të strukturës së re organizative, ku Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë iu bashkua Instituti i Studimeve dhe Projektimit të Mbrojtjes (ISPMb) është e domosdoshme të bëhet ndryshimi i ligjit ekzistues me një ligj të ri. | Përcaktimi i qartë i ndarjes së kompetencave dhe detyrave në përputhje me strukturën e re organizative të IGJIU-së. | Jo | Jo | N/A | Po |